



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 37

Tiranë – E hënë, 19 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 47/1, datë 6.12.2016	Për shprehje interesi “Supervising/Civil works Engineer”- “Supervizor/Inxhinier për punimet civile”.....	3
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.(11-2016-5031) 1641, datë 8.11.2016	Me objekt: Mbylljen e procedurës së falimentimit.....	4
Kërkesë e Ministrisë së Financave nr. 17249, datë 14.12.2016	Për shitje.....	7



**KËRKESË
E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
nr. 47/1, datë 6.12.2016**

**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF
INTEREST (REOI)
(CONSULTING SERVICES)**

December 6, 2016

Albania Health System Improvement Project
(HSIP)

Loan No: 8466 AL.

Project ID Number: P144688

Assignment Title: "Supervising / Civil works Engineer"

Reference No. HSIP/CS/IC/08-2015

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The Objective of this assignment is to hire a "Supervising / Civil works Engineer", who will oversee and coordinate the civil works activities and other related activities, which are planned to be financed under the HSIP project.

The selected Consultant shall assist PCU and MoH staff by providing a range of services that will ensure that the civil works for the physical closure and environmental remediation of the facilities are designed, carried out and monitored in line with good local practice and law, to the satisfaction of the main stakeholders.

The Consulting Engineer shall have a minimum relevant experience of ten (10) years as civil engineer/ works supervisor. Also, it is expected that the consulting engineer shall be

proficient in English language and computer literate. He should have:

- University degree in civil works.
- General experience on the Construction field not less than 10 years.
- Experience in supervision and construction of administrative and public buildings
- Have a minimum of (5) five years of experience in multi-disciplinary supervision of Public Building and its coordination;
- Working experience in the WB financed project or other international organization it is preferable.
- Experience or knowledge as material engineer is preferable
- Sound and good knowledge of Government rules and legal requirements in Albania in related to development permit, design standards and supervision.
- Very good Command of Albanian and English language (spoken and written) is essential.

- Excellent computer skills and knowledge of the MS Office suite (primarily Word, Excel, PowerPoint, Auto Cad), and online document-sharing platforms;

The Ministry of Health, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible individual local consultants ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	General Qualifications	30 points
2.	Specific Experience in the field of the assignment	50 points
3.	Language and General Experience	20 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Supervisor/Civil works Engineer should be an Individual Local Consultant. The selection method to be applied is Individual Consultant Consultants (IC), in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants



Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers” (January 2011, revised July 2014).

The duration of the assignment is 12 months , with 3 months trial period, from contract signing with option of renewal , based on satisfactory performance.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by December 20, 2016.

Ministry of Health (MoH)
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)
Tirana, Albania
Att: Blerina Dudushi
e-mail: hsip.dudushi@gmail.com
Att: Elma Dogani
e-mail: hsip.dogani@gmail.com

VENDIM

Nr.1641, datë 8. 11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë nga:

Kryetari i seancës gjyqësore Petraq Çuri,
Asistuar nga sekretarja Eriola Gashi, në Durrës, më datën 8.11.2016, mori në shqyrtim, me dyer të hapura, çështjen civile që i përket palëve ndërgjyqëse;

KËRKUESE: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, përfaqësuar nga Elvin Shllaku në bazë të autorizimit nr.17612/1 Prot datë 4.11.2015.

Persona të tretë: l. Shoqëria “Inter Gaz” sh.a., me administrator Piro Bare dhe me seli në Porto Romano, 500 metra në veri të hidrovorit, godina 3-katëshe, përfaqësuar në bazë të autorizimit datë 4.11.2015 nga Ralf Spiro.

2. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, në mungesë.

3. Administratori i falimentimit Rrapo Xhaferaj.

ME OBJEKT: Mbylljen e procedurës së falimentimit.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008, nenet 141 deri 149, 1-21, 39, 40, 120 etj.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasi administroi provat dhe aktet e ndodhura në dosje, dëgjoi paditësin, i cili kërkoi pranimin e kërkesëpadisë;

Palën kërkuese, Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, që kërkoi mbylljen e procedurës së falimentimit;

Palën e paditur, shoqërinë “Inter-Gaz” sh.a., që u shpreh dakord;

Palën e tretë, QKB Tiranë, në mungesë;

Administratorin e falimentimit, Rrapo Xhaferaj, që kërkoi pranimin e kërkesës;

VËREN:

Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, ka paraqitur kërkesë para gjykatës dhe me palë të tretë, shoqërinë “Inter-Gaz” sh.a., me seli në Durrës, me objekt: “Kërkesë për çeljen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Inter-Gaz” sh.a.”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 7320 datë 27.6.2013, ka vendosur deklarinimin e moskompetencës tokësore të saj dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si gjykatë kompetente.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin datë 10.2.2014, ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës të palës kërkuese, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Hapjen e procedurës së falimentimit për palën e tretë, shoqërinë “Inter-Gaz” sh.a. me seli, në Durrës, Porto Romano, 500 metra në veri të hidrovorit, godina 3-katëshe, me objekt veprimtarie, tregti me shumicë e pakicë, e gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre, përpunim, prodhim të nënprodukteve të gazit, ambalazhimin e tyre me shumicë e pakicë.

Të caktojë si administrator të falimentit Robert Begaj, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, rruga “Medar Shtylla”, 48/1.

Hapja e procedurës së falimentit u krye në ora 13 e 30' të datës 10.2.2014.



Vendosjen e sekuestros konservative mbi pasurinë me nr. 66/14, ZK 3184, truall me sipërfaqe 27683 m² dhe sip. ndërtimore 4422 m².

Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, duhet të paraqesë te administratori i falimentit, pretendimet e tyre me shkrim, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Afati i paraqitjes së pretendimeve nga pala kreditore nuk mund të jetë jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga data e këtij vendimi.

Pala e tretë debitore shoqëria “Inter-Gaz” sh.a., duhet që detyrimet e saj t’ia paguajë administratorit të falimentit.

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 649 datë 23.6.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës.

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:

Gjykata pas dhënies së vendimit të mësipërm ka vazhduar me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, duke zëvendësuar administratorin e falimentimit Robert Begaj me Rrapo Xhaferraj me vendimin e datës 20.10.2015.

Procedura e falimentimit ka vazhduar nën administrimin e administratorit të falimentimit Rrapo Xhaferraj, i cili paraqiti para gjykatës “Raport periodik nr. 2 janar-shtator 2016, mbi mbikëqyrjen e realizimit të planit të organizimit”.

Në konkluzionet përfundimtare administratori shprehet:

“7. Konkluzione përfundimtare

Ky raport është i mbështetur në ligjin për falimentimin si dhe vendimin e gjykatës për raportimin periodik nga ana e administratorit të falimentimit bazuar në nenin 223-224, dhe 225 të ligjit “Për falimentimin” dhe është realizuar në bashkëpunim me debitorin dhe bazuar në pasqyrat financiare të 9-mujorit të vitit 2016, të plotësuar sipas standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, si dhe standardeve të administrimit të masës së falimentimit, treguesit ekonomik-financiare janë plotësuar normalisht dhe kanë qenë me tregues të lartë pozitiv.

Zbatimi i këtij plani riorganizimi deri më sot i ka plotësuar kërkesat e kreditorëve dhe të drejtat e tyre janë ekzekutuar në formën e kërkuar nga ligji dhe sipas grafikut mujor të planit të riorganizimit, nuk ka pasur asnjë ankim nga kreditorët pranë gjykatës dhe administratorit të

falimentimit, gjë që është një faktor shumë pozitiv për mbylljen me sukses të kësaj procedure falimentimi për periudhën deri në këtë datë raportimi.

Në këto rrethana bazuar në nenet 221, 222, 231 të ligjit, meqenëse shlyerja e pretendimeve të kreditorëve është përmbushur plotësisht nga ana e debitorit, para afatit sipas pjesës trajtuese të planit të riorganizimit dhe sipas rezultateve ekonomik-financiare, kjo shoqëri është në gjendje të administrohet nga debitori me anë të Këshillit Mbikëqyrës, duke pasur përfaqësues ligjor administratorin e emëruar nga asambleja e aksionarëve, duke ju kthyer të gjitha të drejtat që të disponojnë lirisht masën e falimentit dhe çdo pasuri të saj që ka në posedim, të jetë aktive, si dhe të hiqet emërtimi si “shoqëri në procedurë falimentimi” duke njoftuar QKB-në, si dhe duke e shpallur vendimin në Qendrën e Publikimeve Zyrtare.

Në këto kushte, kërkoj mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Inter-Gaz sh.a.”, si dhe heqjen e funksioneve të administratorit të falimentimit z. Rrapo Xhaferraj”.

Neni 221 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” shprehet:

“1. Sapo vendimi që miraton planin e organizimit merr formë të prerë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.

2.....

3. Ky vendim dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht. Debitori, administratori i falimentimit dhe anëtarë të komitetit të kreditorëve njoftohen që më parë për datën kur hyn në fuqi mbyllja e procedurës.”.

Gjykata, me vendimin datë 31.3.2016, ka vendosur miratimin e planit të organizimit të Shoqërisë “Inter-Gaz”, sh.a., i cili ka marrë formë të prerë, mbasi me të kanë ardhur në dijeni të gjitha palët.

Në rrethanat kur nga administratori i falimentimit Rrapo Xhaferraj, konstatohet se gjendja financiare e shoqërisë është rentabël dhe me mundësi të mëdha ekonomike për vazhdimin e veprimtarisë së saj tregtare private, gjykata vlerëson se duhet të mbyllë procedurën e falimentimit.

Neni 222 i ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, shprehet:



“1. Me mbylljen e procedurës së falimentimit mbarojnë edhe të gjitha funksionet e administratorit të falimentimit dhe të anëtarëve të komitetit të kreditorëve. Debitorit i kthehet e drejta të disponojë lirisht masën e falimentimit.
.....”

Gjykata vlerëson se në këtë rast gjejnë zbatim këto dispozita e pikërisht nenet 221 e 222 të ligjit 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata pasi pa dhe nenet 31, 32, 58, të KPC-së, ligjin nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”,

VENDOSI:

Të mbyllë procedurën e falimentimit ndaj Shoqërisë “Inter-Gaz” sh.a., hapur me vendimin datë 10.2.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Mbarimin e funksioneve të administratorit të falimentimit Rrapo Xhaferraj.

T’i kthehet debitorit, shoqërisë “Inter-Gaz” sh.a. masa e falimentimit.

Një kopje vendimi t’i dërgohet QKB-së Tiranë dhe një kopje vendimi Fletore Zyrtare në Qendrën Botimeve Zyrtare Tiranë. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Për palën në mungesë ky afat fillon nga dita e komunikimit të këtij vendimi.


Durrës, më 8.11.2016

GJYQTARI
Petraq Çurri

Shpenzimet gjyqësore	
Njoftime	3500 lekë
Totali	3500 lekë



**KËRKESË
E MINISTRISË SË FINANCEVE
Nr. 17249, datë 14.12.2016**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me vam fillestar, si më poshtë:

SHOQËRITË HUAMARËSE NË ADMINISTRATIM

1. Pronësi të Shoqërisë "Kamberi" në administrim

Nr	Emërtimi	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Njësi tregtare	Lagja "Kushtrimi, Vlorë	4 200 000	4 200 000		42	42	10.01.2017	09.00	DDPP
2	Ish-Pularia	Fshati Grize, Patos, Fier	12 244 829	11 553 204	691 625	1 375	372	10.01.2017	09.30	DDPP


Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. Mandat pagesën apo Garancinë bankare në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", Kapitulli III, shpall për shijë me Vam fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
Objekteve 1-7 të pronës Nr. 1046 me emërtesë "Ish N/Reparti AKA 2825	Kala, Berat	9,682,907	7,128,681	2,554,226	801.2	801.2	10.01.2017	10.00	DDPP

1. Në varësi administrative të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
"Oficinë"	Burrel	17,672,508	14,766,658	2,905,850	2225	706	10.01.2017	10.30	DDPP

1. Në administrim të Njësisë Administrative Pirg

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
"Ish-Vatër e Kulturës"	Sovjan, Korçë	1,067,161	991,113	76,048	388	388	10.01.2017	11.00	DDPP



1. Në administrim të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Nr	Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	“Kati katërt i zyrave” të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	Pogradec	5 057 858.4	4 474 821.1	583 037.3	230.3	230.3	10.01.2017	11.30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. Mandat pagesën apo Garancinë bankare në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).


Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. Mandatpagesën apo Garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësi etj. nëse ka të tilla.
5. Deklaratë notoriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesari në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", Kapitulli III, pika 14, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
"Truproje-Depo-Lavanteri"- ish Grup AKA	Lavdan, Ballsh	2,392,887	447,339	1,945,548	612	76.6	10.01.2017	12.00	DDPP

1. Në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarjes

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
Klub, mence, guzhinë (2 kt)	Trebinjë, Pogradec	1 880 460	1 579 500	300 960	480	480	10.01.2017	12.30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. Mandat pagesën apo Garancinë bankare në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.



2. **Mandatpagesën apo Garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.


3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHETETËSE DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me vëm fillëstar, si më poshtë:

1. Në pronësi të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjetet kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
Magazinë	Lagja "Çirimi", Lushnjë	11 850 000	8 571 750	3 278 250	470	48	11.01.2017	10.00	DDPP
"Ullishte"	Durrës	111 780 000	0	111 780 000	9 000	0	11.01.2017	10.30	DDPP
"Arë"	Durrës	44 800 000	0	0	4 000	0	11.01.2017	11.00	DDPP
"Arë"	Durrës	74 520 000	0	0	6 000	0	11.01.2017	11.30	DDPP
"Garazh nr.1"	Sarandë	2 400 000	2 400 000	0	48.5	48.5	11.01.2017	12.00	DDPP
"Ullishte"	Durrës	26 910 000	0	0	1 500	0	11.01.2017	12.30	DDPP
Makinë "Mitsubishi-Pajero"	Tiranë	115 000	115 000	0			11.01.2017	13.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. Mandat pagesën apo Garancinë bankare në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016